

Shkurt mbi shkollën e mesme të veçantë 2013



Në shkollën e mesme të veçantë (gymnasiesärskolan) nxënësve me pengesa në zhvillim u jepet një bazë e mirë që të shkollohen më tutje, të kërkojnë punë e të munden të marrin pjesë aktive në jetën shoqërore. Përveç kësaj shkolla e mesme e veçantë krijon mundësi për zhvillim personal.

Shkollimi duhet ta stimulojë bashkësinë sociale dhe t'ua zhvillojë nxënësve aftësinë që në mënyrë të pavarur dhe bashkë me të tjerët t'u përkushtohen diturive dhe t'i thellojnë e zbatojnë këto. Prandaj shkolla e mesme e veçantë është shumë fleksible ashtu që nxënësit të zhvillohen sa më shumë sipas synimeve të shkollimit.



Programet e shkollës së mesme të veçantë

Shkolla e mesme e veçantë përbëhet nga programet shtetërore dhe individuale. Programet shtetërore janë

Programi për administrim, tregti dhe menaxhim mallrash

Nxënësve u jepen dituri themelore për administrim, tregti dhe menaxhim mallrash. Shkollimi i përgatit nxënësit për punë me p.sh. detyra të thjeshta administrative, marketing praktik dhe dokumentim të thjeshtë. Gjatë shkollimit nxënësit gjithashtu zhvillojnë një qasje me orientim shërbimi dhe aftësi që të komunikojnë dhe bashkëveprojnë me myshterinj.

Programi për veprimtari estetike

Nxënësve u jepen dituri themelore për veprimtari estetike dhe trajta të shprehjes. Në këtë program nxënësve u jepet mundësia të provojnë të komunikojnë me figura, tekste dhe tinguj. Shkollimi në këtë program nuk ka ndonjë orientim të prerë profesional por duhet të rezultojë në atë që nxënësi të jetë në gjendje të marrë pjesë në projekte të ndryshme artistike dhe të vazhdojë të studiojë ose të punojë në fushën e estetikës. Dituritë mundën gjithashtu të jenë të përdorshme në parashkollore dhe në veprimtari të ndryshme passhkollore për fëmijë.

Programi për ndërtesa, objekte rrugore dhe ndërtimtari

Nxënësve u jepen dituri themelore për ndërtesa, objekte rrugore dhe ndërtimtari. Shkollimi i përgatit nxënësit që p.sh. të mundën të punojnë me ndreqje dhe mirëmbajtje ndërtesash ose me sipërfaqe tokësore ose me mirëmbajtje të ambienteve të parqeve.

Programi për mirëmbajtje automjetesh dhe menaxhim mallrash

Nxënësve u jepen dituri themelore për mirëmbajtje automjetesh dhe menaxhim mallrash. Shkollimi i përgatit nxënësit që p.sh. të mundën të ndreqin automjete dhe makina, të lajnë dhe rikondicionojnë vetura dhe të ngasin trak. Gjatë shkollimit nxënësit gjithashtu zhvillojnë një qasje me orientim shërbimi dhe aftësi që të komunikojnë dhe bashkëveprojnë me myshterinj.

Programi për zejтари dhe prodhim

Nxënësve u jepen dituri themelore për histori të zejtarisë, teknologji të zejtarisë dhe prodhim. Gjatë shkollimit nxënësit mësohen gjithashtu të përdorin vegla dhe metoda prodhimi dhe t'i zhvillojnë dituritë mbi materialet që përdoren në fushat profesionale të programit.

Programi për hoteljeri, restorante dhe furra

Nxënësve u jepen dituri themelore për hoteljeri, restorante dhe furra. Shkollimi i përgatit nxënësit që të mundën të punojnë me p.sh. mallra furrash e ëmbëltoresh, higjienë mallrash ushqimore, shtruarje tavolinash, gatim ushqimi dhe shërbime hoteli. Gjatë shkollimit nxënësit gjithashtu mësohen të zhvillojnë një qasje me orientim shërbimi dhe aftësi që të komunikojnë dhe bashkëveprojnë me myshterinj.

Programi për shëndet, shëndetësi dhe përkujdesje

Nxënësve u jepen dituri themelore për shërbime dhe përkujdesje në sektorin e kohës së lirë dhe të shëndetësisë. Shkollimi i përgatit nxënësit që të mundën të punojnë me p.sh. ushqim dhe shëndet, punë përkujdesi dhe përkujdesje shëndetësore. Gjatë shkollimit nxënësit gjithashtu mësohen të zhvillojnë një qasje me orientim shërbimi dhe aftësi që të komunikojnë dhe bashkëveprojnë me njerëz të tjerë.

Programi për shoqëri, natyrë dhe gjuhë

Programi i arsimit nxënësit pikësëpari në lëmenjtë e shkencave shoqërore dhe gjuhë. Përveç kësaj ka mundësi për thellim ose zgjerim diturishë në media dhe ekologji.

Programi për pyje, tokë dhe shtazë

Nxënësve u jepen dituri themelore për natyrë, ekologji dhe teknologji të punimit të tokës. Shkollimi i përgatit nxënësit që të mundën të punojnë me p.sh. tokë dhe ambiente të jashtme, bimë, ambiente bimore dhe shtazë. Gjatë shkollimit nxënësit gjithashtu mësohen të zhvillojnë një qasje me orientim shërbimi dhe aftësi që të komunikojnë dhe bashkëveprojnë me njerëz të tjerë.

Shkalla e notave

Në programet shtetërore jepen nota për çdo kurs të përfunduar. Nëse e kalon kursin me sukses të jepet nota E, D, C, B ose A. Nota më e lartë është A dhe nota më e ulët është E.

Nëse nuk i plotëson kushtet për notën E nuk të jepet asnjë notë.

Punimi i shkollës së mesme të veçantë tregon se a mundet nxënësi të kryejë detyra të zakonshme të punës

Të gjithë nxënësit në programet shtetërore bëjnë nga një punim të shkollës së mesme të veçantë (gymnasiesärskolearbete). Punimi duhet të jetë në përputhje me synimet programore dhe me shkollimin e nxënësit.

Punimi i shkollës së mesme të veçantë duhet të tregojë që nxënësit janë në gjendje të kryejnë detyra të zakonshme të punës brenda një fushe profesionale. Prandaj punimi i shkollës së mesme të veçantë bëhet në fund të shkollimit.

Mësuesi e vlerëson punimin e shkollës së mesme të veçantë dhe vendos se a është kaluar me sukses apo jo. Për një punim të shkollës së mesme të veçantë të kaluar me sukses jepet nota E. Nëse nxënësi nuk i arrin synimet mësuesi nuk vë asnjë notë.

Programet individuale

Ata nxënës të cilët nuk janë në gjendje ta vijojnë mësimin në një program shtetëror mund të shkojnë në një program individual. Programet individuale i përmbajnë këto fusha lëndore (ämnesområden):

- veprimtari estetike
- dituri shtëpijake e konsumatore
- edukatë fizike
- natyrë dhe ekologji
- individ dhe shoqëri
- gjuhë dhe komunikim.

Përveç kësaj nxënësi mundet të ketë praktikë nëse kjo është e mirë për nxënësin.

Një fushë lëndore mundet të përbëhet nga pjesë të më shumë se një lënde. Për çdo fushë lëndore ka nga një plan të fushës lëndore (ämnesområdesplan). Ai e përshkruan synimin e mësimin dhe caqet për ato që duhet t'i mësojnë nxënësit.

Në vend të notave mësuesi jep vlerësime të diturive të nxënësit duke u nisur nga kushtet për dituri themelore dhe për dituri të thelluara. Në këtë mënyrë nxënësi mundet t'ia përshtasë kushtet mundësive të çdo nxënësi.

Në programet individuale mund të kombinohen lëndët nga programet dhe fushat lëndore shtetërore. Drejtori i shkollës vendos se cilat lëndë mund të kombinohen.

Nga një plan mësimor për çdo nxënës

Të gjithë nxënësit në shkollën e mesme të veçantë kanë nga një plan të vetin mësimor. Ai përmban të dhëna mbi atë se

- në cilin program merr pjesë nxënësi
- cilat kurse ose fusha lëndore duhet t'i mësojë nxënësi
- a është programi i plotë, i reduktuar ose i zgjeruar
- cilat kurse përfshihen në programin e plotë
- cilat kurse nuk përfshihen në programin e plotë
- cilat kurse i përmban programi i reduktuar dhe cilat kurse janë hequr.

Dëftesa e shkollës së mesme të veçantë

Pas shkollimit në programet shtetërore dhe individuale nxënësve u jepet nga një dëftesë e shkollës së mesme të veçantë. Në të përshkruhet se cilat dituri dhe përvoja i ka fituar nxënësi nga shkolla e mesme e veçantë dhe ka të dhëna mbi

- programin
- fushat lëndore ose kurset të cilat i ka mësuar nxënësi
- notat
- mësimin e vendosur në vend të punës dhe praktikën
- punimin e shkollës së mesme të veçantë.



Programi i introduksionit i shkollës së mesme të veçantë (IM)

Nxënësit të cilët e kanë kryer shkollën fillore të veçantë kanë të drejtë të vijojnë mësimin në ndonjë nga programet e introduksionit, introduksioni profesional, alternativa individuale dhe introduksioni gjuhësor. Programet e introduksionit duhet t'u japin mundësi të reja nxënësve pa kualifikim.

Introduksion profesional

Introduksioni profesional është për të gjithë të rinjtë të cilët nuk kanë nota të mjaftueshme për t'u kualifikuar për ndonjë program profesional. Nxënësve u jepet mësimi me drejtim profesional që ua lehtëson atyre futjen në tregun e punës ose në studime në ndonjë program profesional.

Alternativa individuale

Alternativa individuale i përgatit nxënësit për ndonjë shkollim tjetër ose për punësim. Shkollimi formohet duke u nisur nga secili nxënës dhe u drejtohet të rinjve të cilët nuk kualifikohen të pranohen në ndonjë program shtetëror profesional.

Introduksioni gjuhësor

Introduksioni gjuhësor është një shkollim ku mësohet shumë suedishtja, për të rinjtë e sapoardhur në Suedi. Pas introduksionit gjuhësor nxënësit mundin të vazhdojnë më tutje në ndonjë shkollim tjetër, për shembull në ndonjë program tjetër introduksioni.

Nxënësit me pengesa në zhvillim ose dëmtim në tru

Shkollimi në shkollën e mesme të veçantë është për ato të rinj të cilët e kanë kryer shkollën fillore ose shkollën fillore të veçantë dhe që nuk janë në gjendje t'i përmbushin kushtet e diturisë në shkollën e mesme për shkak të ndonjë pengese në zhvillim ose dëmtimi në tru.

Që të mundet të vendoset se ai takon një nxënës grupit përkatës për të cilin është ky shkollim, komuna ku është nxënësi me banim bën një shqyrtim me vlerësim pedagogjik, psikologjik, mjekësor dhe social. Ai shqyrtim merret për bazë për vendimin e komunës për atë se a i takon nxënësi grupit përkatës apo jo.

Nxënësit e shkollës së mesme të veçantë kanë mësim me së paku 3 600 orë mësimore nga 60 minuta të shpërndara në katër vite shkollore. Principali i shkollës (komuna ose ndonjë person) vendos mbi numrin e orëve mësimore për çdo kurs dhe për çdo fushë lëndore.



ISBN: 978-91-87115-92-9
Foto: Michael McLain

Skolverket